



A.nr.26/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.26/2025, të datës 09.01.2026 të parashtruar nga ankuesi Y.GJ, nga Mitrovica, kundër organit të punësimit: Komunës së Mitrovicës së Veriut, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.26/2026 e datës 09.01.2026 e parashtruar nga ankuesi Y.GJ. **Shfuqizohet** Vendimi me Nr.01-030/01-0019809-25, i datës 10.12.2025 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjti.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore që në riprocedurë të veproj mbi bazën e pikëpamjeve juridike si në arsyetimin e kiji vendimi, duke nxjerr akt administrativ në pajtim të plotë me ligjin material, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil Y.GJ, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 09.01.2026, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.01-030/01-0019809-25, të datës 10.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Veriut, ndërsa, kjo e fundit ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 48/2026 të datës 09.01.2026; Vendimin me Nr.01-030/01-0019809-25, i datës 10.12.2025 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore; Vendimin me numër te protokollit 01-030/01-0011543/2025 i datës 16.07.2025; Akt emërimit me numër te protokollit 01-030/01-0013291/24; Vendimin për Konfirmimin e Marrëdhënies së Punës me numër të protokollit 01-030/01-0008182/25 i datës 26.05.2025; Akt emërimit me numër e datës 01.07.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Diplomën e nivelit bachelor të ankuesit; Korrespondenca me Departamentin e Thesarit në Ministrinë e Financave lidhur me mos ekzekutimin e vendimeve për ushtrues detyre.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur së çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organin administrativ që ka nxjerr aktin e kontestuar më ankesë, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2025 është i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor në Zyrën Ligjore pranë Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Tutje, sipas Vendimit me numër 01-030/01-0011543/25, të datës 16.07.2025, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, ankuesi është emëruar ushtrues i detyrës së Udhëheqësit në Zyrën Ligjore, ndërsa, sipas Vendimit me Nr. 01-030-01-0019809/2,5 të datës 10.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut është anuluar Vendimi me numër 01-030/01-0011543/25, i datës 16.07.2025, me arsyetimin se pozitat me të cilat janë emëruar si ushtrues detyre të udhëheqësit në drejtoritë dhe sektorët përkatëse nuk janë të parapara me buxhetin aktual komunal dhe as atë të vitit 2026, anulohen të gjitha vendimet për ushtrues detyre të udhëheqëseve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr. 01-030-01-0019809/25 të datës 10.12.2025 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, me pretendimin së akti i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me nenin 53 të Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse, më anulim të vendimit numër 01-030/01-0011543/25, të datës 16.07.2025, ankuesit i janë cenuar interesat legjitime, dhe se njëti cenon edhe të ardhurat e tij materiale. Propozon që ankesa të aprovohet, të anulohet Vendimi me numër 01-030-01-0019809/25 i datës 10.12.2025, i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore dhe të mbetet në fuqi Vendimi me numër 01-030/01-0011543/25, i datës 16.07.2025, i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore.

Në kuptim të bazës ligjore lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës, Kolegji i'u referua nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit, si dhe nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: 1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari, dhe si rrjedhojë, bazuar në këtë përcaktim*

ligjor rrjedhë së Kryetari i Komunës në cilësi të titullarit ka autorizimin ligjor dhe diskrecional të bëjë emërimin e ushtruesve të detyrave për pozita e lira drejtuese, më kushtin që jenë respektuar kërkesat ligjore për emërimin e ushtruesit të detyrës, e mbi këtë bazë, titullari i institucionit ka autorizimin që të bëjë edhe shfuqizimin/anulimin e vendimeve për emërimin e ushtruesve të detyrës në rastet kur vlerësohet se janë përmbushur kushtet ligjore për në veprim të tillë.

Ndërsa, në kuptim të efekteve juridike vepruese (*ex nunc – ex tunc*) të akteve administrative, Kolegji iu referua nenit Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me theks të veçantë:

-Nenit 53 [Procedura dhe efektet e anulimit dhe shfuqizimit], ku përcaktohet se: *1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm. 3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.*

-Nenit 55 [Anulimi apo shfuqizimi diskrecionar i një akti administrativ të paligjshëm], ku përcaktohet se: *1. Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë. 2. Një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nëse pala përfituese është në mirëbesim, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet. 3. Pala përfituese nuk do të vlerësohet në mirëbesim nëse ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit, ose nuk ka qenë në dijeni të tyre për shkak të pakujdesisë së rëndë apo nëse akti është nxjerrë bazuar në informacionin materialisht të gabuar apo jo të plotë, të dhënë nga vetë pala.*

Andaj, Kolegji bazuar në dispozitat ligjore si më lartë dhe marrë parasysh rrethanat e rastit ku ankuesi nga data 16.07.2025 deri më 10.12.2025 ka ushtruar detyrën e Udhëheqësit të Sektorit Ligjor, duke nënkuptuar se i njëjti nga kjo pozitë ka ndërmarr veprime ligjore dhe administrative që kanë krijuar pasoja juridike, atëherë, Vendimi me numër 01-030/01-0011543/25, i datës 16.07.2025, duhej të shfuqizohej ashtu që i njëjti të ketë pasoja në të ardhmen *ex nunc* sepse vetë mbi këtë bazë arrihet siguri juridike dhe nuk cenohen situatat e krijuara në të kaluarën.

Thënë si më lartë, Kolegji duke u bazuar në dispozitat e nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të aprovojë ankesën si të bazuar, të shfuqizohet Vendimi me Nr.01-030/01-0019809-25, i datës 10.12.2025 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjti, më detyrimin që Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore në riprocedurë të veproj mbi bazën e pikëpamjeve juridike si në arsyetimin e kiji vendimi, duke nxjerr akt administrativ në pajtim të plotë me ligjin material, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.26/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, Y.GJ;*
- *Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*